



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.342/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi Kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 06.02.2025, mori këtë :

V E N D I M

I. **PRANOHET E BAZUAR** ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.342/2025 datë 03.02.2025.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 Euro (dymijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet kandidatja e subjektit politik LDK, Bahrije Hyseni që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj posterin e vendosur në shtyllën e ndriçimit publik në Fshatin e Vjetër në Rr.“Hysen Statovci”, Komuna Ferizaj.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.342/2025, në të cilën pretendohet se më datë 03 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Ferizaj ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/ objektet/rrugët publike, të kandidatës për deputet nga radhët e të LDK-së, Bahrije Hyseni përkatësisht në shtyllën e ndriçimit publik në Fshatin e Vjetër në Rr.”Hysen Statovci”, Komuna Ferizaj.

Me këtë veprim kandidatja dhe Subjekti Politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën-paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP.

Provë: Fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se pretendimet e Pretendimi se kandidatja për deputete znj. Bahrije Hyseni ka shkelur nenin 34 paragrafi I nenparagrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk qëndron, sepse znj. Hyseni ka marr gjobën sipas Vendimit të PZAP-se, A.nr. 285/2025, datë 03.02.2025, dhe konsiderohet si çështje e gjykuar tashmë resjudicata, andaj kërkojmë që ankesa e LVV të hedhet poshtë si e palejuar.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli me vendimin e tij Anr. 285/2025 datë 03.02.2025 e ka pranuar të bazuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënimin më gjobë në lartësi prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) Euro, dhe e ka detyruar të njëjtën që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Në ankesën e Anr.342/2025 datë 03.02.2025 subjekti politik LVV thekson se ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/ objektet/rrugët publike, të kandidatës për deputet nga radhët e të LDK-së, Bahrije Hyseni përkatësisht në shtyllën e ndriçimit publik në Fshatin e Vjetër në Rr. "Hysen Statovci", Komuna Ferizaj.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës si dhe të fotografisë së ofruar si provë materiale ka gjetur se posteri i kandidatës për deputet nga radhët e të LDK-së, Bahrije Hyseni është ende i vendosur në shtyllën e ndriçimit publik në Fshatin e Vjetër në Rr. "Hysen Statovci", Komuna Ferizaj.

Paneli vlerëson se me këto veprime kandidatja e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK) Bahrije Hyseni, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim:1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidatja Bahrije Hyseni, përkatësisht subjekti politik LDK përkundër vendimit të formës së prerë të PZAP-it A.nr.285/2025 datë 03.02.2025 nuk i është përmbajtur detyrimit që të largoj posterin nga vendi ku ka qenë i vendosur ai, andaj bazuar në këtë vendim të PZAP-it, urdhërohet kandidatja e subjektit politik LDK Bahrije Hyseni që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj posterin nga shtylla e ndriçimit publik në Fshatin e Vjetër, Rr. "Hysen Statovci", Komuna Ferizaj.

Njëherit njoftohet subjekti politikë në fjalë se duhet të veproj sipas nenit 120, par.2 të LZP, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.342/2025 datë 06.02.2025

**Kryesuesi i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa bazuar në nenin 118 paragrafi 4 të LZP-së.